



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**  
*Qeveria - Vlada - Government*

Nr. 01/100  
Datë: 26.04.2019

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr. 02/2011 për Fushat e Përgjegjësive Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren Nr. 15/2017, me Rregulloren Nr. 16/2017, me Rregulloren Nr. 07/2018, me Rregulloren Nr. 26/2018 dhe me Rregulloren Nr. 30/2018, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 26 prill 2019, nxjerr këtë:

**V E N D I M**

1. Emërohet Komisioni Përzgjedhës për rekomandimin e kandidatëve për anëtarë në Bordin e Organit Shqyrtues të Prokurimit, në këtë përbërje:
  - 1.1. Rozafa Ukimeraj, Sekretare e Përgjithshme e MAPL-së, kryesuese;
  - 1.2. Qemajl Marmullakaj, Sekretar i Përgjithshëm i MD-së, anëtar;
  - 1.3. Naim Baftiu, Sekretar i Përgjithshëm i MF-së, anëtar;
  - 1.4. Osman Vishaj, Përfaqësues i KRPP-së, anëtar;
  - 1.5. Isuf Zejna, Demokracia Plus, anëtar.
2. Komisioni Përzgjedhës për rekomandimin e kandidatëve për anëtarë në Bordin e lartcekur do të zbatojë rregullat e Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik në Republikën e Kosovës, me ndryshimet dhe plotësimet e bëra me Ligjin Nr. 04/L-237, Ligjin Nr. 05/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-092.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

**Ramush HARADINAJ**

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**  
*Qeveria - Vlada - Government*

---

Nr. 02/100  
Datë: 26.04.2019

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr. 02/2011 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren Nr. 15/2017, me Rregulloren Nr. 16/2017, me Rregulloren Nr. 07/2018, me Rregulloren Nr. 26/2018 dhe me Rregulloren Nr. 30/2018, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 26 prill 2019, nxjerr këtë:


**V E N D I M**

1. Aprovohen pjesërisht kërkesat e Shoqatave të dala nga Lufta e UÇK-së, për ndarjen e mjeteve financiare në vlerë prej 390,000.00 € (treqind e nëntëdhjetë mijë) euro.
2. Mjetet nga pika 1. e këtij vendimi ndahen nga Shpenzimet e Paparashikuara me kod 232 nën programi Shpenzimet e Paparashikuara me kod 13100, kategoria e shpenzimeve e rezervës dhe transferohen në Ministrinë e Financave në nën programin Thesari me kod 201-11200 në kategorinë e shpenzimeve subvencione dhe transfere, për Shoqatat e dala nga Lufta e UÇK-së, si në vijim:
  - 2.1. Organizatës së Veteranëve të Luftës së UÇK-së: 132.000 €, në xhirollogarinë NLB Prishtina 1701001010734491, të dedikuara për:
    - 52.000 €, për funksionim, pjesëmarrje në konferenca evropiane dhe botërore;
    - 60.000 €, për rehabilitimin e trajtimin e 300 veteranëve në banja termale;
    - 20.000 €, për mbulim të shpenzimeve për varrim të veteranëve.
  - 2.2. Shoqatës së Invalidëve të Luftës së UÇK-së: 126.500 €, në xhirollogarinë ProCredit Bank 1110003683000163, të dedikuara për:
    - 30.000 €, për funksionim;
    - 40.000 €, për rehabilitimin e trajtimin e 200 invalidëve në banja termale;
    - 56.500 €, për rehabilitimin e 300 invalidëve të luftës në bregdet.
  - 2.3. Shoqatës së Familjeve të Dëshmorëve të UÇK-së: 131.500 €, në xhirollogarinë ProCredit Bank 1110270777000187, të dedikuara për:
    - 35.000 €, për funksionim;
    - 40.000 €, për rehabilitimin e trajtimin e 200 familjarëve të dëshmorëve në banja termale;
    - 56.500 €, për rehabilitimin e 300 familjarëve të dëshmorëve në bregdet.

3. Obligohet Ministria e Financave, për zbatimin e këtij vendimi.

4. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

**Ramush HARADINAJ**



---

Kryeministër i Republikës së Kosovës

**Iu dërgohet:**

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**  
*Qeveria - Vlada - Government*


Nr. 03/100  
Datë: 26.04.2019

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr. 02/2011 për Fushat e Përgjegjesisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren Nr. 15/2017, me Rregulloren Nr. 16/2017, me Rregulloren Nr. 07/2018, me Rregulloren Nr. 26/2018 dhe me Rregulloren Nr. 30/2018, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, duke iu referuar kërkesës së Komunës së Rahovecit, nr. prot. 297 datë 22.03.2019, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 26 prill 2019, nxjerr këtë:

**V E N D I M**

1. Ndahen mjete financiare në shumë prej 1,000,000 euro Komunës së Rahovecit, për sanimin e dëmeve të shkaktuara nga breshëri dhe vërshimet.
2. Mjetet nga pika 1. e këtij vendimi ndahen nga Shpenzimet e Paparashikuara me kod 232 nën programi Shpenzimet e Paparashikuara me kod 13100, kategoria e shpenzimeve e rezervës dhe transferohen në komunën e Rahovecit me kod 623 në nën programin Bujqësia me kod 47011 në kategorinë e shpenzimeve Subvencione dhe Transfere.
3. Obligohet Ministria e Financave dhe Komuna e Rahovecit për zbatimin e këtij vendimi.
4. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

**Ramush HARADINAJ**

  
Kryeministër i Republikës së Kosovës

**Iu dërgohet:**

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**  
*Qeveria - Vlada - Government*

Nr. 04/100  
Datë: 26.04.2019

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 3 paragrafi 1. të Ligjit Nr. 04/L-163 për Mallrat e Liruara nga Tatimi Doganor dhe Mallrat me Tarifë Zero të Tatimit Doganor, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr. 02/2011 për Fushat e Përgjegjesisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren Nr. 15/2017, me Rregulloren Nr. 16/2017, me Rregulloren Nr. 07/2018, me Rregulloren Nr. 26/2018 dhe me Rregulloren Nr. 30/2018, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 26 prill 2019, nxjerr këtë:

**V E N D I M**

1. Aprovohet kërkesa e Ministrisë së Financave për lirim të normës së taksës doganore në zero (0) për mallrat me kodet si në vijim:
  - 1.1. Kodi i mallrave 0101 - Kuaj, gomarë dhe mushka;
  - 1.2. Kodi i mallrave 0102 - Gjedhe të gjalla;
  - 1.3. Kodi i mallrave 0103 - Derra të gjallë;
  - 1.4. Kodi i mallrave 0104 - Dele dhe dhi të gjalla;
  - 1.5. Kodi i mallrave 0105 - Shpend të gjallë, dhe
  - 1.6. Kodi i mallrave 0106 - Kafshët tjera të gjalla.
2. Obligohet Ministria e Financave dhe Dogana e Kosovës për zbatimin e këtij vendimi.
3. Obligohet Zyra e Kryeministrit ta njoftojë Kuvendin e Republikës së Kosovës për këtë vendim.
4. Vendimi hyn në fuqi me datë 01 maj 2019.

**Ramush HARADINAJ**

Kryeministër i Republikës së Kosovës

**Iu dërgohet:**

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**  
*Qeveria - Vlada - Government*

Nr. 05/100  
Datë: 26.04.2019

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 3 paragrafi 1. të Ligjit Nr. 04/L-163 për Mallrat e Liruara nga Tatimi Doganor dhe Mallrat me Tarifë Zero të Tatimit Doganor, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr. 02/2011 për Fushat e Përgjegjesisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren Nr. 15/2017, me Rregulloren Nr. 16/2017, me Rregulloren Nr. 07/2018, me Rregulloren Nr. 26/2018 dhe me Rregulloren Nr. 30/2018, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 26 prill 2019, nxjerr këtë:

**V E N D I M**

1. Aprovohet kërkesa e Ministrisë së Financave për lirim nga tatimi doganor Bashkësitë Fetare të parapara me legjislacionin në fuqi për liritë fetare në Kosovë, për mallrat e importuara nga shitja e të cilit realizojnë qëndrueshmërinë e tyre financiare.
2. Lirimi nga tatimi doganor sipas paragrafit të parë të këtij vendimi vlen vetëm për sasinë e nevojshme për sigurimin e qëndrueshmërisë financiare të asaj Bashkësie Fetare.
3. Obligohet Ministria e Financave dhe agjencitë e saj varëse për zbatimin e këtij vendimi.
4. Vendimi hyn në fuqi me ditën e nënshkrimit.

**Ramush HARADINAJ**

Kryeministër i Republikës së Kosovës

**Iu dërgohet:**

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**  
*Qeveria - Vlada - Government*

Nr. 06/100  
Datë: 26.04.2019

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. të nenit 93 paragrafi (4) dhe të nenit 17 paragrafi 1. të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 4 paragrafi 2. të Ligjit Nr. 04/L-052 për Marrëveshjet Ndërkombëtare, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr. 02/2011 për Fushat e Përgjegjësive Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren Nr. 15/2017, me Rregulloren Nr. 16/2017, me Rregulloren Nr. 07/2018, me Rregulloren Nr. 26/2018 dhe me Rregulloren Nr. 30/2018, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 26 prill 2019, nxjerr këtë:

**V E N D I M**

1. Aprovohet në parim Nisma e Ministrisë së Financave për negocimin e Marrëveshjes në mes të Qeverisë së Republikës së Kosovës, e përfaqësuar nga Ministria e Financave, dhe Qeverisë së Republikës së Francës Lidhur me Vendosjen dhe Aktivitetin e Agjencisë Franceze për Zhvillim, PROPACO-s, dhe Expertise France në Kosovë.
2. Përgjatë negocimit të kësaj marrëveshjeje, Ministria e Financave obligohet të procedojë konform dispozitave të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të Ligjit për Marrëveshjet Ndërkombëtare dhe dispozitave tjera ligjore në fuqi.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

**Ramush HARADINAJ**

Kryeministër i Republikës së Kosovës

**Iu dërgohet:**

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**  
*Qeveria - Vlada - Government*

---

Nr. 07/100  
Datë: 26.04.2019

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr. 02/2011 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren Nr. 15/2017, me Rregulloren Nr. 16/2017, me Rregulloren Nr. 07/2018, me Rregulloren Nr. 26/2018 dhe me Rregulloren Nr. 30/2018, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 26 prill 2019, nxjerr këtë:

**V E N D I M**

1. Aprovohet Raporti Tremujor i Buxhetit për vitin 2019.
2. Obligohet Sekretari i Përgjithshëm i Zyrës së Kryeministrit që Raportin nga pika 1. e këtij vendimi ta dorëzoj në Kuvendin e Kosovës konform kërkesave të nenit 45 të Ligjit Nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

**Ramush HARADINAJ**

Kryeministër i Republikës së Kosovës

**Iu dërgohet:**

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë





**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**  
*Qeveria - Vlada - Government*

---


Nr. 08/100  
Datë: 26.04.2019

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr. 02/2011 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren Nr. 15/2017, me Rregulloren Nr. 16/2017, me Rregulloren Nr. 07/2018, me Rregulloren Nr. 26/2018 dhe me Rregulloren Nr. 30/2018, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 26 prill 2019, nxjerr këtë:

**V E N D I M**

1. Aprovohet Programi i Borxhit Shtetëror për vitet 2020 – 2022.
2. Obligohet Sekretari i Përgjithshëm i Zyrës së Kryeministrit që Programin nga pika 1. e këtij vendimi ta dorëzoj në Kuvendin e Kosovës konform kërkesave të nenit 15 të Ligjit Nr. 03/L - 175 për Borxhet Publike.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

**Ramush HARADINAJ**

  
Kryeministër i Republikës së Kosovës

**Iu dërgohet:**

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**  
*Qeveria - Vlada - Government*


Nr. 09/100  
Datë: 26.04.2019

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të Ligjit Nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjet Nr. 03/L-221, Nr. 04/L-116; Nr. 04/L-194; Nr.05/L-063, Nr. 05/L-007, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr. 02/2011 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren Nr. 15/2017, me Rregulloren Nr. 16/2017, me Rregulloren Nr. 07/2018, me Rregulloren Nr. 26/2018 dhe me Rregulloren Nr. 30/2018, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 26 prill 2019, nxjerr këtë:

**V E N D I M**

1. Aprovohet Korniza Afatmesme e Shpenzimeve 2020-2022.
2. Obligohet Sekretari i Përgjithshëm i Zyrës së Kryeministrit që Kornizën nga pika 1. e këtij vendimi t'ia procedojë Kuvendit të Republikës së Kosovës.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

**Ramush HARADINAJ**



Kryeministër i Republikës së Kosovës

**Iu dërgohet:**

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë